

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Gysi dhe Vlora detyrojnë Ramën të sulmojë median dhe drejtësinë - REPORT.AL
ADRESA	https://report.al/gysi-dhe-vlora-detyrojne-ramen-te-sulmoje-median-dhe-drejtesine/
BURIMI	report.al
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	27 shtator 2026, 13:59:07 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 900 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	27 shtator 2026, 13:58:54 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	ce73b7f9a2347072fbbabbf1799a19a214bb8281612e4b082b6005c427425f82
TEKSTI	34a12fac057ff813d6290ca103d22b25f7de5caa8f08b93a742f74bf23b24e1b
PAMJA	ca9b9b50807751b82469f3646d4bcb60bdf86e3fdfecce6e2ca68d8e9c8eb5a0

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	e5bb6620765360d037c1ab5a0266329aafb50db5cb6229e63d47b3cd0e41c5b7
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	9def72ec67cc19e19d7afdb89aaceb893ee05eec68643756bafa9738daebd45d
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërin nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/e5bb6620765360d037c1ab5a0266329aafb50db5cb6229e63d47b3cd0e41c5b7>

PAMJA E FAQES


Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

Home Aktualitet

Gysi dhe Vlora detyrojnë Ramën të sulmojë median dhe drejtësinë

by Lajm Lajm — September 27, 2026 in Aktualitet, Kryesore

0
SHARES

Share on Facebook

X Share on Twitter

Edi Rama ka reaguar për zhvillimet e fundit pas arrestimit të ish-drejtueses së SHISH, Vlora Hyseni duke e cilësuar situatën si një çështje që kërkon adresim të menjëhershëm.

Nga Rinasi, Rama tha se masa e marrë ndaj ish-drejtueses së SHISH është një masë ekstreme, duke theksuar rëndësinë e institucionit të sigurisë kombëtare.

"Zhvillimet e ditëve të fundit pas arrestit të ish drejtueses së SHISH kërkojnë një adresim të menjëhershëm. Ishte një masë ekstreme, po të mbajmë parasysh po të bëjmë fjalë për ekspozimin e një institucioni kyç.

Cdo dyshim i arsyeshëm duhet të hetohet deri në fund. Çdo akuzë duhet të provohet ose të rrëzohet. Cdo masë kufizimi e lirisë nga organi i akuzës, për cilindo që nuk ka imunitetit kundërshtohet vetëm në gjykatë dhe jo në podiumin e kryeministrit", tha Rama.

Ai shtoi se respektimi i pavarësisë së drejtësisë nuk nënkupton heshtjen për çështje që prekin interesin shtetëror.

"Këto piketat e vijës së sjellje tme ndaj çështjeve individuale të drejtësisë kane qenë dhe mbeten kështu, për të gjithë. Respekti për pavarësinë e drejtësisë nuk do të thotë heshtje", tha Rama.

Teksa synon që të bëhet avokat i Vlora Hysenit dhe Ergys Agasit, Rama detyrohet të sulmojë mediat dhe drejtësinë që po bëjnë punën e tyre.

Arrestii i ish-kreut të SHISH, Vlora Hysenit dhe hetimi i saj nga SPAK, janë një çështje individuale e saj me drejtësinë, tha kryeministri Rama. Ai bëri thotë se drejtësia e mediat duhet të kryejnë detyrat e tyre respektive me hetimin apo informimin, por jo të bëjnë dikë fajtor.

"Drejtësia nuk mund ta luftojë nalinishmërinë në ohorrin e sinërmarrjes apo krimin na adresuar

TË FUNDIT

Gysi dhe Vlora detyrojnë Ramën të sulmojë median dhe drejtësinë

SEPTEMBER 27, 2026

Zjarr në çatinë e një hoteli në qendër të Shkodrës

SEPTEMBER 27, 2026

Pacienti ndërroi jetë, nisin hetimet për dy mjekët neurologë në Shkodër

SEPTEMBER 27, 2026

Në kërkim nga autoritetet italiane dhe kosovare, dy të arrestuar në Tiranë, pritet ekstradimi – EMRAT

SEPTEMBER 27, 2026

Pesticidet në fruta e perime/ Agronomët kërkojnë protokoll të ri dhe përdorimin e preparateve me karencë të shkurtër

SEPTEMBER 27, 2026

"Je rrezik për sigurinë kombëtare", Azgan Haklaj ndalohet në kufirin e Bllatës

SEPTEMBER 27, 2026

Fluturaku Albatros në çerdhen e pushtetit!

SEPTEMBER 27, 2026

"Rama nuk pranohet!" / Ish-zv.ministri: Në New York përjetoi bllokadën më të fortë diplomatike

SEPTEMBER 27, 2026

Furnizonin me drogë shkollat e Tiranës/ Mes të arrestuarve edhe një ish-efektiv policie

SEPTEMBER 27, 2026

Shpërthen bombola e gazit në një banesë në Maliq, plagoset 74-vjeçari

SEPTEMBER 27, 2026

paligjshmërinë në oborin e vet. Pavarësia e drejtësisë smund të shfaqet si shkëputje nga Kushtetuta dhe shpërfillje. Prokuroria ka të drejtën dhe detyrën të hetojë, gjykata të gjykojë, media të zbulojë dhe informojë, por askush s'ka të drejtë ta shpallë tjetrin fajtor dhe ta dehumanizojë. Shteti ligjor ndërtohet me kurajën për të hetuar të fuqishmin dhe sigurinë për të mbrojtur të drejtat e njeriut që heton. Për sa më takon, kur një zyrtar i lartë i ka hapur vetes një llogari me drejtësinë, edhe kjo e ish-drejtueses së SISH, është një çështje individuale mes saj dhe organeve të drejtësisë. Nuk kam asgjë tjetër për të shtuar", tha Rama.

Rama ia ngec ndërkombëtarëve fajin për Vlora Hysenin

Rama tha se emërimi i Hysenit në drejtimin e Shërbimit Informativ të Shtetit ishte bërë edhe në bazë të vlerësimeve dhe referencave që, sipas tij, ajo kishte marrë nga partnerët ndërkombëtarë.

Rama tha se e kishte vlerësuar punën e Hysenit dhe se ajo fillimisht kishte punuar pranë tij si këshilltare për sigurinë. Sipas kryeministrit, më pas ajo u emërua në krye të SHISH, bazuar në referencat që ai i cilësoi si "të shkëlqyera" nga partnerët ndërkombëtarë.

"Vlora Hyseni ka hyrë në një borxh të madh moral me këtë vend", deklaroi Rama.

Rama sulmon SPAK e GJKKO

Rama sulmoi SPAK dhe GJKKO sepse, sipas tij, nxorën në pazar sekretet hetimore.

"Nuk mund të lincohet një institucion dhe një ish-drejtuese në këtë farë derexheje. Nuk mund të trajtohen çështjet me thashetheme. Njerëzit nuk mund të shpallen fajtorë pa nisur gjyqi. Vlora Hyseni u lincua përpara se ta gjykojë gjykata. SPAK dhe GJKKO nxorën në shesh secrete hetimore që diskutohen si thashetheme në publik

Çdo masë kufizimi e lirisë nga organi i akuzës, për cilindo qoftë që s'ka imunitet parlamentar, kundërshtohet vetëm në gjykatë dhe jo me opinion e krye as në foltoren e Kryeministrit.

Respekti për pavarësinë e drejtësisë nuk do të thotë heshtje edhe kur një shqetësim parimor shfaqet gjatë veprimtarisë së organeve të saj.

Në këtë rast, përveç dhe përtej çështjes penale individuale, ka një fakt tjetër parimor, shtetëror, që nuk mund të anashkalohet sikur s'ka ndodhur.

Gjatë marrjes së masës dhe administrimit gjyqësor të dosjes, një institucion me ndjeshmëri të veçantë u ekspozua ndaj potencialit të një dëmi të madh, që mund dhe duhej të ishte parandaluar plotësisht.

Të dhënat e dosjes hetimore vërshonin nëpër kanale sociale, para se gjykata të urdhëronte kufizimin e publikimit të tyre", tha Rama.

Ora luksoze dhuratë nga bota e krimit?

Rama reagoi edhe ndaj akuzave të opozitës se ka marrë si dhuratë një orë të shtrenjtë nga krimi i organizuar. Duke folur nga Rinasi, Rama i ka quajtur deputetët e opozitës si pisanjosë me kostum parlamentar.

Rama tha se të gjitha dhuratat që ka marrë gjatë detyrës si kryeministër janë regjistruar si pronë e shtetit shqiptar dhe se ato nuk i ka marrë në të quajtur në shtetin e tij

"Kush ka përfituar të drejta kushtetuese të zhvillimit të pronës apo mundësi të ligjshme investimi, e di shumë mirë çfarë flas, e di shumë mirë çfarë them kur them se pushteti im nuk është përdorur për të dhënë favore të errëta. Sot në Kryeministri ka një muze të dhuratave. Atyre pisanjosëve me kostum parlamentar, të cilët kanë nxjerrë edhe një orë super të shtrenjtë që paskam marrë dhuratë nga krimi i organizuar, u them se në atë muze ka një duzinë orësh të shtrenjta dhe super të shtrenjta, të cilat më janë dhuruar mua nga miq të fuqishëm apo vizitorë të huaj. Ndryshe nga paraardhësi im, që i ka përçarë të tëra bashkë, unë i kam regjistruar të gjitha dhuratat për Kryeministrin si prona të shtetit shqiptar. Sepse çfarë vjen për mua si Kryeministër dhe çfarë më takon ta kem si Kryeministër, nuk vjen për ta çuar në shtëpinë time," tha Rama.

Rama akuza Prokurorisë së Tiranës

Rama deklaroi se me paratë e 'fabrikës së vdekjes' në Gërdec u ngrit një 'lavatriçe mediatike' që kurdin bombat 'na mbyti korrupsioni'.

Përballë akuzave të opozitës, Rama solli si kundërshtim 21 Janarin dhe Gërdecin, duke treguar e në të kaluarën drejtësia pengohet nga pushteti.

"Pikërisht për emrin, për Shqipërinë, e dua me kokën lart, me flamurin sa më lart, të barabartë, në tryezat më të larta, në BE brenda kësaj deкаде me drejtësi të pavarur prej meje. Prandaj sot, më kanë ndaluar në këtë sallë tema e drejtësisë dhe kurrë kundërshtarët e mi, që nga të përdalët e rrugëve opozitare të dështak zemërakët kujtojnë se kanë shpikur bombën që do hedhë Edi Ramën. Le ta hedhin atë bombë mëngjes drekë dhe darkë. Ta shpërthejnë orë e çast në pasqyrat sociale a thua se përsëritja e një fjale të ndryrë do zhbëjë pastërtinë e luftës sime të gjithanshme që duan s'duan i riktheu këtij vendi kryeqytetin e varrosur në plehra dhe po transformon Shqipërinë dhe ngre vendin drejt një maje ku ska qenë kurrë. Në asnjë vend të mbytur me korrupsion nuk ka luftë frontale kundër korrupsionit. Në asnjë vend të mbytur prokuroria nuk heton vetë pushtetin por i mbron ata. Në asnjë vend drejtësi nuk prek ministra, drejtorë, kryetarë bashkish por vetëm rri dhe pret urdhërin e pushtetit për të goditur kundërshtarët. Vendi e mbytur në korrupsion e kemi jetuar të gjithë ku kryetari i opozitës burgosej me urdhër nga lart, ku protestuesit vriteshin me plumba të paguar nga taksapaguesit, ku fletëthirrjet e prokurorisë për vrasjet shtetërore në mes të bulevardit bëheshin letra higjienike në zyrën e kryeministrit që denigronte prokuroren si lavire bulevardi., ku drejtori i taksave qëndronte në krye të detyrës nga arresti shtëpiak e 26 të pafajshëm të vrarë në shpërthimin e një projekti korruptiv të Ministrisë së Mbrojtjes u trajtuan si viktime të fatkeqësisë natyre. Ata 4 të vrarë në bulevard nuk kanë marrë drejtësi" tha Rama.

Rama ka sulmuar 2 media gjatë fjalimit të tij në Rinas. Rama i ka akuzuar këto televizione për përdorim të fondeve të paligjshme dhe për ndikim mbi organet e drejtësisë, duke i quajtur si 'lavatriçe mediatike'.

Më tej ai ka deklaruar se prokurorët e treshur dhe të trembur nga evazoni mbajnë peng Prokurorinë e Tiranës dhe çështje evazoni dhjetëra miliona euro

"E di që me paratë e fabrikës së vdekjes në Gërdec u financua ngritja e një lavatriçe mediatike, që kurdin sot bombat çuditërisë antiqeveri. E di që një tjetër TV, 'korrupsion, na mbyti korrupsioni', i ushqyer nga paratë e evazonit, ka marrë peng një prokurori të tërë, në Tiranë.

Prokurorët e trembur dhe të treshur hapin çështje që të trembin punonjësit e tatimeve që denoncojnë evazonin." tha Rama

Tags: [Edi Rama](#) [vlera hyseni](#)

Previous Post

[Zjarr në çatinë e një hoteli në qendër të Shkodrës](#)



Lajm Lajm

REPORT.AL

Portali report.al është një media online e pavarur që sjell lajme, analiza dhe informacione të sakta në kohë reale. Me fokus tek transparencë dhe vërtetësia, portali synon t'u ofrojë lexuesve shqiptarë një burim të besueshëm lajmesh nga politika, ekonomia, shoqëria dhe ngjarjet ndërkombëtare.

RUBRIKAT

- Aktualitet
- OP-ED
- Politike
- Rajon
- Showbiz
- Sociale
- Shëndet
- Sport

MË TË KLIKUARAT



E rëndë në Dibër, 22-vjeçarja mbytet në lumin Drini i Zi

01

0 SHARES



Makina 150 mijë euro e Grida Dumës, dhuratë nga Ergys Agasi?! Ja çfarë thonë Lolita dhe Elvi Fundo

0 SHARES



Shkarkohet Ilir Topi/ Ish-drejtuësja e CFO Pharma, Rexhina Bici pritet të drejtojë Fondin e Sigurimeve

0 SHARES